

## Vendim nr. 148 datë 27.06.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, në datën 27.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (O) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESI:** OLSI AVDIJA

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për hetim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 5864 të vitit 2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.  
Konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin dhe mbylljen e hetimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 4, 15, 18, 23, 31, 33, 35, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 135 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Olsi Avdija i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një ankesë, e cila, pasi kishte të bënte me pretendime për kryerje të veprave penale, në datën 29.05.2015 i është dërguar për trajtim Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*).

Në vijim, në datën 17.06.2015 kërkuesi ka bërë edhe kallëzim penal përpara oficerit të Policisë Gjyqësore kundër punonjësve të Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) dhe të Bankës së Shqipërisë (BSH).

2. Në kallëzimin e tij kërkuesi ka parashtruar se në datën 24.04.2004 ka marrë një kredi bankare nga BKT-ja për financimin e një pjese të çmimit për blerjen e një apartamenti, në vlerën 32 000 euro, me afat shlyerjeje 120 muaj (10 vjet) dhe me interes të përcaktuar. Nga kredia e akorduar, në fakt, atij i është disbursuar vetëm 28 800 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 3 200 eurosh, që do t'i paguhej shoqërisë sipërmarrëse pas nxjerrjes së certifikatës së pronësisë, nuk i është disbursuar. Më tej, kërkuesi ka pretenduar se gjatë zbatimit të kontratës, në vitin 2009 dosja e tij e kredisë i është transferuar një filiali tjetër të BKT-së, ku dhe është mbyllur kredia në datën 02.05.2014, pas shlyerjes së plotë të saj prej tij. Pikërisht në këtë kohë, sipas kërkuesit, shoqëria sipërmarrëse ka filluar procedurën për dorëzimin e certifikatave të pronësisë, duke i kërkuar atij pagimin e çmimit të mbetur prej 3 200 eurosh. Kërkuesi ka pretenduar se pas kësaj ka kërkuar të gjithë dokumentacionin e kredisë së tij, duke paraqitur edhe ankesa pranë BSH-së, ku nga informacioni i marrë nga kjo e fundit ka konstatuar se BKT-ja i ka raportuar asaj për një kredi të marrë prej tij, që ishte e ndryshme për nga vlera, interesi dhe afati i shlyerjes me atë të marrë në fakt, çka ngrinte dyshime për fshehje të të ardhurave (mosdeklarim të interesit të vjelur), me qëllim shmangien nga taksat, falsifikim të dokumenteve dhe shpërdorim detyre nga punonjësit e BKT-së, përveçse edhe shpërdorim detyre nga punonjësit e BSH-së të ngarkuar me mbikëqyrjen e bankave të nivelit të dytë.

3. Mbi kallëzimin e kërkuesit, në datën 15.07.2015 Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr. 6864 për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Fshehja e të ardhurave” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 186, 180 dhe 248 të Kodit Penal (KP). Në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është shënuar emri i ndonjë personi që i atribuoheshin veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal. Në përfundim të hetimeve paraprake, me vendimin e datës 30.12.2015, prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga hetimi i kryer nuk rezultoi elemente të ndonjë vepre penale, që do të ngarkonin me përgjegjësi penale ndonjë punonjës të BKT-së dhe BSH-së. Kundër këtij vendimi, bazuar në nenin 329 të KPP-së, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë në cilësinë e të dëmtuarit (viktimës) nga vepra penale.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 426, datë 01.06.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit, duke prishur vendimin e prokurorit të datës 30.12.2015 për pushimin e procedimit penal dhe urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme, ndërsa ka lënë si

detyra pyetjen e kallëzuesit dhe të disa punonjësve të caktuar të BKT-së dhe BSH-së, si dhe administrimin nga BKT-ja të praktikës dokumentare të kredisë dhe nga BSH-ja të praktikës dokumentare të verifikimit të ankesës së kallëzuesit. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

5. Në zbatim të vendimit gjyqësor, Prokuroria e Tiranës ka vijuar hetimet paraprake, në përfundim të të cilave, me vendimin e datës 20.01.2017, prokurori ka vendosur sërish pushimin e hetimeve. Kërkuesi ka paraqitur përsëri ankim në gjykatë kundër këtij vendimi.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 406, datë 05.05.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit për pushimin e hetimeve, duke urdhëruar vazhdimin e tyre, me arsyetimin se nuk janë pyetur të gjithë shtetasit për të cilët gjykata kishte lënë detyrë në vendimin e saj të mëparshëm. Ky vendim, pas ankimimit nga kërkuesi, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1763, datë 02.07.2018, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-146, datë 30.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, në kushtet kur ai ka hequr dorë prej tij.

7. Ndërsa hetimet paraprake vijonin, në datën 12.02.2024 kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Zakonshëm Tiranë kërkesë për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit në procedimin penal nr. 6864/2015 nga Prokuroria e Tiranës; përshpejtimin e procedurave dhe urdhërimin e marrjes së veprimeve të caktuara: (i) mbylljen e hetimeve brenda 5 (pesë) ditëve dhe kalimin e çështjes në gjyq brenda 5 (pesë) ditëve; (ii) zbatimin e vendimeve penale të formës së prerë. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim në seancën e datës 25.03.2024, por gjykimi është shtyrë për mungesë të prokurorit për në datën 13.05.2024.

8. Ndërkohë, në datën 05.04.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar, është regjistruar në datën 16.04.2024. Në datën 04.06.2024 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës së hetimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë 9-vjeçare, në tejkalim të afatit ligjor, nuk ka përfunduar hetimet

paraprake dhe nuk ka marrë vendim për procedimin penal nr. 5864 të vitit 2015. Çështja penale është regjistruar në organin e akuzës në datën 15.05.2015, është pushuar dy herë pa të drejtë nga ana e tij, si dhe aktualisht ndodhet ende nën hetim, duke penguar kërkuesin të ushtrojë të drejtat e tij ligjore penale e civile në procesin gjyqësor. Organi i akuzës nuk po zbaton vendimin penal nr. 426, datë 01.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është i formës së prerë. Po kështu, nuk ekzistojnë arsye për tejkalimin e afatit ligjor për hetimin e çështjes, pasi: (i) nuk konstatohet që hetimi i procedimit penal të shfaqë ndonjë kompleksitet që të justifikojë kohëzgjatjen e tij; (ii) nga ana e kërkuesit nuk është bërë ndonjë kërkesë për zgjatje të hetimit, por përkundrazi ai i është drejtuar organit të prokurorisë për informacion në lidhje me ecurinë e tyre dhe mbylljen e hetimeve, por nuk ka marrë përgjigje; (iii) për sa i përket sjelljes së autoriteteve rezulton se veprimet hetimore kanë qenë të ngadalta, sjellja e zyrtarëve nuk ka qenë e duhura, si dhe organi i akuzës nuk ka plotësuar të gjitha detyrat e lëna nga gjykatat e faktit me vendim të formës së prerë; (iv) për sa u përket pasojave që mund të vijnë nga tejkalimi i afatit të arsyeshëm të hetimeve paraprake, sipas kërkuesit, ekziston rreziku i parashkrimit të veprave penale dhe personi përgjegjës të mos marrë dënimin sipas ligjit. Po kështu, kërkuesi rrezikon të humbasë mundësinë e paraqitjes së padisë civile në procesin penal dhe të mos dëmshpërblehet sipas ligjit.

9.1.2. *Së drejtës së gjyimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi edhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka cenuar të drejtën për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur afatin procedural 45-ditor të përcaktuar në nenin 399/7 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9.1.3. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit dhe nuk është shprehur me vendim brenda afatit ligjor 45-ditor, duke i mohuar atij të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor për çështjen e parashtruar, qoftë edhe në disfavor të tij. Ajo nuk ka marrë për bazë faktin që kërkuesi është palë në një proces gjyqësor penal dhe civil, e për rrjedhojë ai ka legjitimitet aktiv, pasi i cenohet e drejta e pronësisë si palë paditëse, kallëzues dhe viktimë e veprës penale, si dhe të drejtave që i jep ky i fundit, në kuptim të nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së dhe neneve 399/1 e vijues të KPC-së.

- 9.1.4. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi organi i akuzës nuk ka përfunduar hetimin e çështjes brenda afatit ligjor dhe nuk ka dalë me vendimmarrje lidhur me të prej 9 vjetësh nga momenti i regjistrimit të procedimit penal. Po kështu, edhe gjykata e shkallës së parë, duke mos shqyrtuar çështjen brenda afatit 45-ditor, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk mund të ketë afate dhe sjellje të ndryshme për gjykatën dhe të ndryshme për individin. Ajo ka disponuar jo në bazë të ligjit, por në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, duke i mohuar atij të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor që i jep zgjidhje çështjes së tij.
- 9.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë një vendim që shprehet për objektin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi për konstatimin e cenimit të afatit të përfundimit të hetimeve penale. Në këto kushte, ajo ka shkelur nenet 135 dhe 142 të Kushtetutës.
- 9.2. *Parimi i barazisë para ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykata e shkallës së parë gjykon çështje të ndryshme bazuar në standarde të ndryshme për sa i përket respektimit të afatit 45-ditor për shqyrtimin e tyre. Në rastin konkret, ajo ka shkelur afatin e arsyeshëm 45-ditor për gjykimin e çështjes së parashtruar nga kërkuesi, ndërkohë çështje të tjera ajo i ka shqyrtuar brenda afatit ligjor. Në rrethanat kur individë të ndryshëm në kushte të njëjta trajtohen në mënyrë të ndryshme, ka diskriminim dhe në rastin konkret subjekti i diskriminuar është kërkuesi.
- 9.3. *E drejta e pronës dhe ajo e zhdëmtimit*, të garantuara nga nenet 41, 42 e 44 të Kushtetutës, pasi si pasojë e tejkalimit të afatit të arsyeshëm të hetimeve paraprake nga ana e organit të akuzës kërkuesi është zhveshur nga pasuria dhe i janë cenuar të drejta të tjera reale. Po kështu, atij i është mohuar e drejta për të kërkuar pushimin e cenimit, kthimin e pasurisë së vjedhur, shpërblimin e dëmit si pasojë e veprës penale, përveçse dënimit të autorit të veprës penale, që është përgjegjësi e shtetit. Në këtë fazë është e pamundur të riparohet situata, pasi në datën kur gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e radhës, shumë nga veprat penale që përbëjnë akuzën parashkruhen.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual në çdo rast duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

11. Lidhur me legjitimitetin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se procesi penal është vënë në lëvizje bazuar në kallëzimin penal të kërkuuesit, ndërsa organi i ndjekjes penale, Prokuroria e Tiranës, e ka pushuar dy herë procedimin penal, por pas vendimmarrjeve të gjykatës mbi ankimin e kërkuuesit, hetimet paraprake vijojnë dhe nuk ka ndonjë të dhënë për përfundimin e tyre. Në këto kushte, kërkuuesi ka përdorur mjetet mbrojtëse të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke paraqitur kërkesë në gjykatën kompetente të shkallës së parë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e hetimit të çështjes nga organi i ndjekjes penale. Në vijim, ndërsa gjykata nuk e ka shqyrtuar kërkesën brenda afatit ligjor 45-ditor, ai ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt në drejtim të afatit të arsyeshëm, si për sa i përket përfundimit të hetimeve të procedimit penal nga Prokuroria e Tiranës, ashtu edhe gjyqimit nga gjykata e shkallës së parë të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Sipas kërkuuesit, shkelja e afatit të arsyeshëm për hetimin e procedimit penal rrezikon

parashkrimin e veprave penale dhe, për pasojë, mosndëshkimin e autorëve të tyre sipas ligjit. Po ashtu, sipas tij, kjo shkelje e pengon atë në ushtrimin e drejtave ligjore në procesin penal, ndërsa i heq mundësinë për të paraqitur padi civile dhe, për pasojë, rrezikon realizimin e së drejtës së dëmshpërblimit sipas ligjit.

13. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se procedimi penal ka në objektin e tij të hetimit veprat penale “Fshehja e të ardhurave”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 180, 186 dhe 248 të KP-së. Këto vepra penale, sipas ligjit procedural penal, ndiqen kryesisht nga organi i prokurorisë, pa pasur nevojën e kërkesës apo ankimit të viktimës së veprës penale, sepse në thelbin e tyre sjellin pasoja ndaj interesave dhe autoritetit shtetëror, arsye për të cilën ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në emër të shtetit kryhet vetëm prej prokurorit. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi, megjithëse interesin për të kërkuar mbrojtjen penale e ka lidhur me të drejta pasurore, për këto të fundit nuk ka kërkuar mbrojtjen civile sipas legjislacionit në fuqi, edhe pse shkeljet e pretenduara të drejtave pasurore nuk lidhen domosdoshmërisht me fajësinë penale të ndonjë personi konkret.

14. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ndonëse kërkuesi ka bërë kallëzim penal për vënien në lëvizje të procedimit penal, ky fakt është i pamjaftueshëm për të justifikuar interesin e tij në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që tejzgjatja e hetimeve paraprake sjell pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të kërkuesit. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

15. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash<sup>1</sup>,

### **V E N D O S I:**

---

<sup>1</sup> Gjyqtaret Sonila Bejtja dhe Marjana Semini votuan për legjitimitimin *ratione personae* të kërkuesit, pasi ai mbart karakteristikat e “viktimës” në çështjen konkrete. Ndaj dhe pretendimet e tij do të duhet të ishin shqyrtuar në seancë për të përcaktuar “interesin që paraqet çështja për kërkuesin”.

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.